P o e z i

Kasam ShAQIRVELA

VALS I TINGUJVE TË ShPIRTIT

Biblioteka: M u z a

autor: Kasam ShAQIRVELA

redaktimi, korrektimi dhe lektorimi:
Shtëpia Botuese " **V E L A** "

Librimi: autori

kontakti në: e-mail: kasamvela@yahoo.com
web faqe: www.kasamshaqirvela.com

profili në fb: email: kasam.shaqirvela@facebook.com
http://www.facebook.com/kasam.shaqirvela

© Kasam Shaqirvela.Të gjitha të drejtat të rezervuara vetëm për autorin.

® "VALS I TINGUJVE TË ShPIRTIT"-Kasam Shaqirvela, i regjistruar si prodhim intelektual.

Kasam ShAQIRVELA

VALS I TINGUJVE TË ShPIRTIT

(p o e z i)

F i l o z o f e m ë

“Shoqëria e jonë do të ecë përpara atëherë kur njerëzit që e udhëheqin atë, do të angazhohen asisoj që, vendit të punës t’i gjejnë njeri e jo njeriut punë.”

Ismen Vebi Shaqiri-Vela

B E S A
(për fjalën e dhënë)

BESA ësht' e ShENjTË, Besa ësht' e rrallë
Ajo duket sheshit, ajo rri në BALİË
Sot e tërë ditën ajo nuk HAROROHET
Vështirë gjendet, me FENER kërkohet.

Besa, s'është veç FJALA e DhËNË
Besa nuk të LIDhË me LITAR
Por është ShPIRTI që ushqen MORALIN
Dhe ai vet TRUNGUN ShQIPTAR.

BESËN ia dhanë edhe Skënderbeut
Vet nipi i tij ia PREU n'Berat
Mira shpirtra FLIJOI veç tradhëtia
Vetëm për LAKMI të vet njerëzia.

S'është pra Besa vetëm FJALA
Që qëndroka pa MORAL n'ShTAT
Por është UNI pra që vepron
Bashkë me MENDJEN bëhen unikat.

BESËN ia prenë edhe Ali Pashës
Tepelena dhe Janina e mbajtën ZI
Sërish tradhëtarët veç për LAKMI,
Pashait KOKA i mbeti n'tepsi.

BESA e MADhE e mori n'qafë
Edhe PLAKUN Imail Qemali
Besën ua dha atyre pa TARAFË
Mu atëherë kur i ShALOHEJ KALI.

Dhe PIRrON e MADh, Besa e preu
BURrI, në të, përherë PËRBEHET
Por LIGËSIA tinzisht ia ktheu
DRURI pasi t‘kalbet, letë ThEHET.

Me besë, udhëtuam drejt TIVARIT,
Të dhënë nga VËLlAU për vëllanë,
Kolona N’ZINXhIRË T’LUFTËTARIT
TRIShTIM për ne, fitim për shkjanë

Besën mund ta jep veç ai NjERI
Që ka GjAK të pastër porsi ARI
Dhe ShPIRTI i vuan për DREJTËSI
MORALIN e ka si QELIBARI.....!

BESA ishte dhe do të mbetet
Ajo që e NGjALl dhe e fik JETËN
Andaj mendohu mirë kur e JEP!
Mos e lejo që AJO të TRETET.

Por dhe RESPEKTOJE tamam si veten
Edhe atëherë kur e ke në XhEP
Se, s’është njësoj si kur e MERr?
Më rëndë e ka ai që Besën ta JEP!

BRENDAZBRAZËTIA

N’ vrapim pas gjërave të mëdha
Ehe pse ata janë të zbazta
Harojmë t’i shohim, para syve,
Gjërat e imëta, pjesë e jetës sonë
Ata na dhurojnë lumturinë
Në shpirtin tonë të stërlodhur
Ne nuk i vërejmë aspak
Harojmë edhe vetveten
Humbemi e largohemi
Për çdo ditë nga pak
Dikur kur të kujtohemi
Mbase dhe do ta njohim
Vetveten pak më mirë
Por koha ka tagrën e vet
Ta ofron atë që të duhet
Jo ti kur e kërkon por,
Kur është koha , siç thuhet
Më vonë don apo s’don,
Tagra shtrenjtë paguhet!

DAShURIA QË FLE NË ZEMËR

Më thanë se ajo tani shkon,
atje, në përjetësi jetën vazhdon.
Jo!-thash: ajo nuk shkon askund
sepse, ajo erdhi nga zemra
edhe kthehet përsëri aty…
…ajo lindi nga zemra….
dhe varroset aty në zemër
…përgjithni…!

Megjithatë Ti po ik përgjitmonë
por, nuk mund ta marrësh
nga zemra ime kujtimin për Ty,
ai është pronë e shpirtit tim,
e kam në zemër, e mbaj fortë,
Dashurinë për Ty
në shtatë palë dyer e ka ndry
Ajo ka ndalur lotin n’qerpikë, dhe
fjalën mendimit n’buzë ia ngrin
malli i lamtumirës me Ty.

Më thanë se koha shëron plagë
dhe dashuria do fiket dikur…
ti,në meskohë, zgjidhe një tjetër
ka shum’ trëndelina kopshti mbi urë,
u zuna ngusht nga shpirti im
dhe ua thash pa qesëndi
në më kuptuan mirë, nuk e di?
Un’ nuk kam faj por zemra ime,
ajo ka vend vetëm për nji.

DËShIRAT E ANIJES

Era nuk pyet për dëshirat e anijes
As për kursin që mba kapitenit i saj
Aspak s’do t’ia di për hallin se
Si anija detit me dallgë do të çaj’?

Delfin nuk bëhet dhe çdokush
Sikur ta merr dhe formën e tij
Shumëkush mbetet gjithnjë makush
Që e fsheh veç kokën në zall’
Se trupi i mbetet sallamadi e n'hall

Nëse një herë e pranove tagjinë
Shkumba buzëve të rrjedhë përherë
Qiraxhiu i yt s’të pyet në ke dimër
Atij gjithnjë i bëhet pranverë.

DhJETË MINUTA NË VIGjILJE TË VITIT TË RI

Vitet vijnë e shkojnë pa u hetuar. Si gjithnji[1]
por euforikisht të festuar. Sa çudi!?
koka është shtatzënë dhe më rëndon mbi supe,
më rëndë se pesha e viteve të mia.

Shumë çështje të pazgjidhura, shumë kriza globale,
si dhe shumë probleme individuale
më kujtohen në këtë natë më universale
dhe më festive, e cila nuk dallon:
as racë as ngjyrë, as religjion as moshë, apo
dykëmbësorë i rëndomtë qoftë, a kampion?!

I vetmuar, në tavolinën për katër persona,
po darkoj me hijen time; bisedoj pa zë!
vera e kuqe më bën shoqëri, për kënaqësi
të momentit dhe dëshirës për shumëçka që
nuk realizohet sonte, megjithatë shpresohet
pafundësisht dhe marrëzisht dëshirohet.

Sonte realiteti duket lakuriq, ngase kështu
ka lindur nga nëna e vet; Zonja Jeta
që ndokujt i hec për toke, e ndokujt
i jep, madje edhe i hap fleta[2].

Disave, në jetë u shkruhet me laps, bile
që e fshinë shumë lehtë edhe më e keqja gomë
ndërsa disave u gërvishtet me gozhdë, në dhimbje,
në vrazhdësi, që se shlyen asnjë bombë.

---

[1] gjithnjë
[2] flatra

Të gjithë urojnë diçka duke cakruar. Thuan:
“Gëzuar, shëndet, suksese, për jetë të gjatë…..!
Akëcili sipas asaj që më parë e ka konceptuar
Gjithkush sipas fatit të vet, që “i lumi” ia ka shkruar

Sado që dikush të mundohet, fatit të vet t’i ikë
kot e ka lum miku, këtu muhabetit i vëhet pikë.
Vitet sikurse vijnë, ashtu edhe shkojnë
si Unë, si Ti, gotën e cakruam për ato që dëshiruam.

Mirpo, mos haro i nderuar festues n’gazmend, se
jelekun tjetërkush ta pret dhe ta qep?!
të vin mirë a s’të vin mirë ty, apo të jep siklet
askush nuk po të pyet për at’ t’madhin dert.

Ti personalisht, vetë, merr dhe jep
kuptohet n’ballafaqim dhe n’balancim
sipas mundësive që jeta vet t’i lejon
madje hiç pa na pyetur, as mua as ty o trim
ti mik i dashur,se, i dua unë apo ti s’i don?!

DRITË ShPIRTI

Zemra është si trëndafili,
po spati dritë ai nuk çelë,
aromën e mba për vete
fletave të pipit mshelë

Rrezja e parë kur e puthë
dhuron shpirt n'të tija fleta
buzëqesh petalja në të çelur
sërish asaj i kthehet jeta

Edhe zemra, po se ndjenë
dritën e shpirtit në agim,
ajo fuqishëm nuk rreh
por veç meket në zhurmim

Ajo e pret trëndafilin
me aromën e tij ta deh
pastaj vetë në pulsim
nëpër pellgje dejsh t'arbnit
të rreh e vetëm të rreh!

EDhE LISI E NDJEU...

Edhe Lisi e ndjeu thyerjen e degës
Atëherë kur rrebeshi mbi kokë i rra
Dëbora s'ndalej, dimri po zgjatej
Degët i theheshin një pas një pa nda

Lisi qëndroi dhe po qëndron
Në dhimbje trupi jetën vazhdon
Nuk dorëzohet e s'mposhtet dot
Ai qanë pa zë dhe s'derdhën lot

Lisi vazhdon jetën me trupin pa degë
Dhe Degët e thyera i mbetën përreth
Ai nxjerr piptha kur vjen pranvera
Por Degët vetë, akoma s'mund t'i ngjes'..?!

Dhe pesë mi ka si dora gishtërinjtë
Plagët e vjetra s'durojnë shami
Ato t'prera lotojnë në pritje përditë
Përderisa likene Lisit i kan' rrën' në sy.

Shekujve mundohet,n'kujtim gjithnji
Don t'Feniksohet, përsëri të ngritet
E ta mbledh hirin, si dikur n'lashtësi
Dhe degët Lisit sërish do t'i ngjiten.

FESTA E FLAMURIT

Edhe kur ishim ndër të parat fillet
Festonim festa nga më të ndryshmet
Por njëra ishte, ku dhe Demi lidhet
Gjuha, Liria me Flamur mbështillet
Atdheu e don, ai, gjithmonë t'i valon

Rruga jonë e madhe, është shum'e gjatë
Shkelur dhe çarë më këmbë nga i joni Tatë
Ngjitur përpjetave me Flamurin, majave ngritur
Tokën e zezë ujitur, pragun e shtëpisë ngjyer
Me gjakun tonë të Arbnit, stërkuqur edhe lyer

Flamuri ka një festë, atë të vetën
Atëherë kur së pari herë e ngritëm
Pastaj, n'rrugëtimin e tij t'etshëm e t'etshëm
Ai veç ngritjen e vet krenarisht
Në përkujtim breznish e përsëritën.

FJALA RrËZON URA

Fjalët e tua rrëzojnë ura të mëdha
Mos mi thuaj me aq zemërim
Vdekja dhe jeta varet nga fuqia e gjuhës
Veç ajo ia jep fjalës të vetin kuptim
Kur ti të ngrihesh mbi vete me ëndje
Atëherë ti do bëhesh lëndë e rrënjës tënde

Nëse s'mund të vdesësh, thoshte një poet
Për secilën fjalë, për secilin varg
Atëherë s'ke lind të krijosh portret
Se ke të vërtetë kohën që e jeton
Kurrë s'dashurohesh n'flakën tënde vetë
Bëma e jote pragun nuk ta kalon.

FJALA MBETI N'GRYK'
(poetëve që ndërruan
jetë si Gjakush Tana)

Dhe, fjala mbeti n'grykë
Se loti i nxehtë valë
rrodhi drejt thembrës
E rendi me nxitim
Sado pak ta fikë
Përflakjen e zemrës

Njeriu i sojit qiri
Udhëtoi n'përjetësi
N'dorëzim la mendimin
Stafetë e flakadan
Ai vetë ndër ikje
T'ndezur la pas vetes
Qirinj, një karvan.

FLETË JETE

Shkoj gjithnjë pas sydritës...!
herë zizifçe, herë valvitës
në zbulim të vetvetes
e në kërkim të t'vërtetës
mbase dhe më të mirës
rrugëtoj këmbëzbathur
drejt dhiareve të rrëpirës,
grep më është bë mendimi
rruginën kënga ma shtron
aty përbrenda, tek burimi
shprirti dritëbardhën kërkon.

Jeta shkruan librat e vet
jo me laps por me vragë i pret
ngjyrëjeta nga paneli ditor
hap e mbyll dritaret n'portret.

Edhe Libri i Jetës ka faqe-fleta
nga jashtë hapmbyllen kopertinat
brenda i mbushë faqet e lumja jeta
ngritje-zbritjet bashkë me greminat.

FRYMË E DAShURISË

Pasqyra e mjegulluar
Tani u ç'mjegullua nga
Fryma e dashurisë.

Atëherë kur do zemra
Ajo shkrin dhe akullin,
Qoftë ai dhe i bezdisë!

GURI I ShKRELËVE
(Azem Shkrelit)

Burri i Shkrelëve
Dikur Poet kur ishte
Katër pika vetvetes
Renditur derejt mi kishte

Me vargun shqip, të Tij
Ai, bënte sinfoninë
Dhe fjalët n’vargun e Tij
Himn për dashurinë

Me vargun e tij vdisje,
Me vargun e tij, prapë, ngjallesh
Varg që s’të lë të dashurohesh kot
Baladadave të jetës në nisje
I përflakur dimrave kallesh.

KALI BARDhË DhE DELFINI

Deti më jep qetësinë
E mali më jep fuqinë
Kali i Bardhë
me jelet si duaj
zgjatur gjer në gjunj
Më inspiron dhe
Shpirtin ma zgjon
Për shtigjet e gjata
Që nga jeta i pata
Zbritjet e ngritjet
Kapur për uni...
si dita, si nata.

Ndërkaq, i bukri Delfini,
Ky banor i Oqeaneve
Mik i dëshmuar i njeriut
Më jep besimin dhe durimin
Për ta sfiduar të keqen
Dhe për të çarë në jetë
Pikërisht si ai, Detin vetë.
Edhe unë, në ato vite
Moshe me energji,
Notoja sikurse delfini
Oqeanit në valëzim
Zemrën mbushur n’gëzim
Dhe vrapoja si Kali Bardhë
Lëndinave e maleve
Të Atdheut të Atit t’im
I prirë me plot dashuri
Trupi edhe Mendja
M’ëndërronin për Liri..!

KThEHEM I DËShPËRUEM

Nuk e di, sa herë edhe unë?
Si i panjohur parkaloj
Përmes këtij kopshti,
Që mba akoma erën time.

Ah, malli im i gjorë?
Shikon nëpër dritare
I pikëlluar dhe i zbrazët
Fati më iku diku larg..!

KUR DhËMBALIA DhEMB

S'është problem se dhëmballa dhemb
Ai hiqet lehtë, me darë largohet
Por nëse dhimbja vjen nga truri
Aty na del me të vërtetë problem
Ai vështirë se mund të shërohet,
Nga ai ngrihet e rrëzohet flamuri.

Një trup që, nga koka nis e kundërmon
Në kalbje vetvetiu ai do shkallëmohet
Aty veç kiretimi shkëlqyeshëm punon
Mjekimi me ilaç vetëm se provohet?!
Por rezultatin e pritur nuk e arsyeton
Koha që humbet, shtrenjtë na kushton!

KUR S'QËLION NË CAK

Shigjeta kur del nga harku
Dikë patjetër do ta godasë
A do të jetë ajo qendra, ose
Periferinë do ta përqasë?
Varet nga ai që shënja i rri pas!

Kjo dashuri do të përfundojë
Deri aty tek buzët tona,
Ajo kurrë nuk do të arrijë
Në zemër, nuk do të flirtojë,
Ti mos lejo të të helmojë.

LIRO ShPIRTI N....!

Po se shkele, fortë, ti veten tënde
Sikurse atdheun, përditë, më këmbë
Matur, pa trishtim, anembanë sinorit
Pëllëmbë për pëllëmbë.....çdoherë...!
S'do ngrihesh ti përmbi të tjerë....
Do dergjesh dimrave gjithmon' i mjerë
Shpirti i frikësuar mbetet përherë vazal
Ti mos ngel pas dhe në jetë mos ndal!
Mençurisht angazhohu, mirë ha veten!
Liro të tjerët dhe shpirtin dhe jetën!
Ti vdis vetëm se një herë...!
Në do të lindësh përgjithmonë
N'pranverë herët, çelja gjethin malit
Dhe vrullin tënd prej djalërie falja Lisit
Nëse do që, lavdinë t'ia vësh' shami ballit
Dhe emri të t'bëhet emblemë e Fisit.

LULJA E KOPSHTIT TIM

Jeta shkruan libra
dhe libri ka fleta
nga jashtë kopertinat
brenda,faqet i mbushë jeta

dielli fshihet prapa malit
e hënës ia heq vellon natën
zemra kërkon zemrën e mallit
a dashuria s'i dorëzohet fatit

dhe kur shikimi e pret shikimin
kthjelltësia e syrit detin e zbehë
kur vesa e puth faqen e trëndafilit
aroma e lules atëherë të dehë

lules i merret erë veç një herë
atëherë kur së pari ajo çelë
herat tjera qoftë dhe n'pranverë
aromën lulja e ka të vjelë

sa herë që shpërthen behari
shpirti përbrenda kallet, përflaket
dhe ndjenja sërish më njgjallet
zemra nuk don asesi të plaket

kërkoj aromën e lules së çelur
tehun e viteve ma tupit dëshira
çmallem në kopështin me lule mbjellur
lulja e kopshtit tim është më e mira

ajo çel edhe n’dimrin e bardhë
nga aroma e saj akulli i shkrirë
peshën e viteve se kam barë
shpirti kërkon shpirtin e lirë.

MALI ZEMRE

Të pres me krahët hapur
netëve dimërore me acar
mëngjeset m'ngrohin sygdhirë
ndjenja krahëve m'rri si pelerinë
të pret ty zemra ime e dlirë
të t'përqafojë në palëshim!
si një pëllumb ...paqeje...
lumturije apo …….
……..dashuri e brishtë në agim ?
do të shtrëngoja çmendurisht
deri sa t'ma dehje shpirtin tim!
pastaj do të mbyll fortë, do të ndryjë
Ty, zjarr zemre, mall-dashuri !
detit të kujtimeve çelësin do ia japë
as peshku i artë s'do arrijë ta kapë
nuk do të mundet më askush
nga zemra ime të të zhdryjë!
ti je dhe mbetesh në mua
prushi që ndez flakën
me emrin dashuri…!

MANUShAQES SË ZEMËRUAR

Se di si ndodhi, cili ia filloi?
tani as mendja nuk ma kujton
por e di se dashuria që lindi
në zemerën time po jeton

Ajo erdhi nga poezitë e tua
dhe në shpirtin tim u strehua
se, sa të desha dhe sa të dua ...?
as zoti i madh s' po m'kupton!

Jo moj zemër, t'i moj manushaqe
se nuk dashta un' me të zemru
por veç desha me t'puth në faqe
po ti s'më le as me tu afru...!?

Pra, mos harxho ti nerva e lot
xhelozinë tënde pse e ushqen ?
gjithëçka që shkruhet në Fejsbuk
veçse dashuri nuk rrëfen....?!

Atë çka zemra e ka brenda
ajo e ruan për jetë e mot...
ia shpreh veç një shpirti...
kur vin koha, ia thot pa lot...!

MASKAT DO T'BIEN

Koha po rrjedh në ngjyra
Si gjethet e vjeshtës së vonë
Sa vie dhe po i njoh
Njerëzit përditë
Nga etja e madhe
Përditshmëria jonë
Në eks po e pi
Kupën e helmit
I ngre dollitë
Një nga një
Dhe s’arrij dot
Të bëhem Sokrat,
Paditem padrejtësisht
Sa herë që unë
Po grisë me thonjë
Maska n’fytyra njeri
Përsëri faji mbetet
Tek unë çuditërisht?!

MENDJEPËRQAFIM

Ti më thirr në emër e un' s'të gjegj
Nuk t'i them gjërat, jo se druaj
Por ato i mbaj në zemër, aty i ruaj
Dhe nuk i përtipë, por veç i bluaj
N't'bardhën, me t'zezë do t'i shkruaj.

Ti mundohesh, shterpë, të mi lexosh
Zhbiron përmbi vello në kuptim
Kot e ke jaran, kurrë s'do t'i kuptosh
Fjalët më janë ylber i pasosur
Prekin teket dhe oreksin e marrosur.

Fjalët e mëdha thuhen përherë
Jo gjithmonë dhe e hapin derën
Sa damkosin peizazhin n'shikim
Veç furça me njgyrë i vë n'shtresim
Dhe syri i atij që mundet t'i zhbirojë
Mes rreshtave, veç ai do t'i lexojë.

METEORI ARVANIT
(Aristidh Kolës)

Dhe lulja e vazos sime
Tha, Meteori Arvanit,
Ec e rritet, synon dritaren,
Andej nga vin drita e diellit
Ajo e kërkon frymëmarrjen

Dhe drita e meteorit shuhet
Kur ai i harkon qiellit
Por vraga që lë pas vetes
Bën dritë si ajo e diellit

Dhe rrugës së tij ngjitet
Nga vetja ndriçuar për liri
Shpejton meteori e digjet
Drejt rrënjës së vet n'Arbëri

Sakrifica sublime bëhet
Kur njeriu bëhet Atdhe
Shpirti i palohet n'alltar
Atje do prehet i qetë do fle.

MUNGESA PËR TY

Puna, obligimet, ngarkesa, shkarkesa
Stresi, pasiguria, koha po shket
Kujtimi, komunikimi, dëshira, haresa
Mungesa për ty shpirtin ma tret

Jam si qielli, mbushur përplot me re
Pështjellur si shtëllunga mjegullat
Të zbrazet kupa pret me nge
Rënduar përbrenda nga ndjenjat

Oh, si nuk gjej një tokë të zhuritur
Përcëllima e saj t'më pret krahapur
Shiun përbrenda që memzi e mba
Tokës së djegur për ujë t'ia kem pa

Avullin nga thellësia që ma nxjerr
T'ia ndjej nga afër, t'ia marr'
Trupin, si mëndafshi t'ma mbështjellë
Ritmin e shpejtuar të zemrës sime
T'ia japë zemrës që digjet si zjarr.

NDENjAT LUAJNË TANGO

Dhe ti e hudh grepin larg
Gjuan gjithmonë në të turbullt
Në detin e mbushur me mëri
Ndjenjat tua luajnë tango
Dhe tablloja shfaqet e zymtë përsëri

Gjithnjë zgjodhe terrin, padijen ..?!
Dhe u mbështete në ta si grep
Tani solle me vete veç hijen
Dhe akoma dëshiron të bëhesh akrep?!

Edhe librin tënd e hape pa dëshirë
Të gjithë do ta lexojnë nga një cep
Fletat e tij do shfletohen pa mëshirë
Dhe Tangoja ndjenjat do t'i step'

Tashmë u bë vonë, tepër vonë për tu kujtuar
Se dhimbja përpiu zemër e mushkëri
Nuk do mjaftojë as uji i detit të trazuar
Ta shuaj' zjarrin që m'djeg në brendi.

NË GjALlIM...

GjUHA e NËNËS,
edhe DhEU i ATIT
gjithmonë, pandalshëm.
NDJENjAT mi ngjallin
Kudoqofsha, kudondodhem
edhe ku marr frymë
m'i përshkohen ShTATIT
me ta unë çlodhem.
Në të BETOHEM un'
sepse e kam LIGJ'
e kam dhe KANUN
dhe përmbi ZAKON
sa ShPIRTI m'i kërkon.
Madje e kam dhe FE
në të un'kam LE
jam rritur me BESËN
ushqyer me ShPRESËN
për timin ATDHE, ku
BUKËS i thuan bukë
ShQIP, edhe UJIT
bashkë me KRIPË
e ZEMËR t'Bardhë.

NJË SHPRESË ZEMRE

Mbase një ditë do takohemi, ku ta di?
një shpresë zemre ma thot për ty
kjo është dëshira e shpirtit tim
por, besoj edhe e jotja dashuri….!

E kur të shkosh për Mëmëdhe
më trego dhe mua se do vi
janë zemrat që flasin për ne të dy
e ndjejnë, e shprehin atë që kan' në brendi

Të puthurat nga larg ti mi dërgon
këtu n'mërgim tek zogu i vrarë
përmes pëllumbit tënd mi kumton
atij sqep-arti, të lumur, të bardhë
e unë po shuaj etjen e zemrës sime
me lotë dëshpërimi në rënkime

Do ta marrë në buzë këtë puthjen tënde
e do ta ngroh me frymen time, me ëndje
e pastaj do ta fus brenda në gjoksin tim
gjersa të arrijë një tjetër, e një tjetër, ...
e në fund ajo origjinalja le të vijë pa kthim
ah, ku trete ti dashuria ime e vjetër?

Vargjet dalin vetë nga zemra ime
e pestër dhe e sinqertë per ty... !
miku im i mirë….zemra s'duron lëndime
të dua.... shumëëëë…..!Pse…të dua?!
as vetë, pse-^{në} e kësaj nuk e di….?

Vetëm unë të shikoja drejt në sy
edhe pse ti qëmoti nuk më sheh

e shikimi im i ëmbël më s’të deh
por, zemra ime, për ty, fortë më rreh
dua të jem së paku një çast pranë teje
vetëm një ledhatim si dikur ta provojë
në krahët e tu, si n’përralla të fle
dashurinë tënde me afsh ta shijojë
dorën tënde në trupin tim ta ndjejë
ëmbël ëmbël tek më ledhaton
si dikur në puthje dhe përqafur ne dy
në gjoksin tënd zemra më gufon
pak më gjatë shpirti do qetësohet
e bashkë me puthjet e mia flej ti
zgjohu me ëndrrat e ylberta
ti dashuria ime, ti e vërteta dashuri.

N'KRAH T'LULEVE

Veç nji her me ba me ra
n'krah’ t'luleve me qa pa za
me e ndi të tyne erë
për me u deh si n’pranverë
zemra ka nji derë me çel
qi na e ban dimrin verë
s'ka murlan ma qi e mshel.

PAKËZ DRITË PËR NjERËZINË

Ah, sikur ta kisha të paktën mundësinë?
Të bëhesha dritë e shpirtit për njerëzinë
Dhe në kësi shteti as këmbën mos ta vë
Shtet ku lulëzon vetëm e keqja mbrapsht
Korrupcioni, vjedhja, rrena me zë e pa zë
Ku ndera dhe vlera s'janë masë për terzinë
Qepur dhe veshur t'i ketë njerëzia
Mburojë nga të ftohti dhe lagështia

Por Ti mos qajë, vetëm duro!
Dhe nëse nuk mund të durosh
Atëherë eja e qaj mbi buzët e mia
Unë kam etje t'madhe dhimbja më tret
Po digjem për ujë shprirti m'ka siklet
Nga lotët e tu t'më shuhet zjarrmia
Ndoshta dhe Ylli këndej do ket' kthim
Dhe njerëzimi një ditë ta sheh dritën
Se na u lodh më shpirti n'lutje-përgjërim
N'kapërcej t'shekujve si shumë pritëm?!

PAMJE JETE

Natyra krijoi me vullnetin e vet
Ligjet e jetës për çdo gjallesë
Dhe male e fusha dhe tokë e det
Një rregulli i mbahen që krijon jetesë

Uji i kulluar eci vijës së hapur
Mision të vetin e pati ujimin
Por pengesat gjatë rrugëtimit të lakur
Pa pyet për detyrën ia ndërprenë udhëtimin

Se koka e mbarsur me të mbrapshtën
Sa lulëzon e keqja dhe degjenerimi ?
Për t'prek modernen e flakëm t'lashtën
Sot degdisur n'halle po rri njerëzimi

Dhe dielli universali, s'i ngroh gjith' njësoj
Ai që ngjitet n'majë t'kodrës qoft dhe me krushqi
E thith ajrin e pastër dhe ngrohtësinë i pari
Ndrsa ai që e kap rrënzën e malit me vështirësi
E thith smokun dhe hija i shtrohet për së mbari!

PËR TY ROZAFË

Emri yt ma prek zemrën time
unë të putha në përkushtim
jepja pra dhe Shkordës trime
merrna Rozafë në përqafim!
Miti vendos për fatin tënd
fustan nusërie të kërkon
një flijimi për Pelorian Pellazg
burimi i jetës jasht' i qëndron.
Zëri ka timbër, kumbon qielli e
përlotet fëmija, n'gji t'nënës vet
zemra digjet, dhe vet Dielli
n'Hënë të plotë nusen e përjet.
Për Ty ROZAFË, mal-mendime tund!
dhe, termiti i kohës ushqim m'i ka
pluhurin e haresës një zog e shkund
shtegëtimit tim nëpër kohësi
dega mallëngjimit përtokë i ra!
vetëm për Ty ROZAFË.....!
malli im, të ndalur s'ka!

PËRKËDhELJA E VITEVE

Shqetësimi e nxiti mundimin
Për një çast i duhet freskimi
Edhe truri e puthi mendimin
Sa për ta zgjuar kujtimin

Përkëdhelja më solli në vete
Nga ëndrra e bukur u përmenda
Do ta ruaj gjatë këtë ndjenjë
Derisa ta mbajë shpirti brenda.

PLAGA IME E VJETËR

Dashuria lindi para njerëzisë
Po nga dhimbja për njerinë
Pas saj lindën edhe të tjera
Që nga vuajtja gëzimin thurën
Se në zemër kishin dashurinë
Lirinë e atdheut tim, Dardaninë.

Koha saldoi e salvoi sa mundi
Rrebeshe, tundime e kataklizma
M'i lidhi sumblla në xhamadan
Nga jeta mendimet nuk mi treti
Në mendje e ngulitur më mbeti
Liria e atdheut të Atit tim Dardan.

Unë vetë, treta botës, pas jetës
Veçse përpara shikova n'marshim
Dashuria më kujtoi për fjalën e dhënë
Tashmë shpirti salvonte për Atë e Nënë
N'kthim prapa kokën, un' pashë trishtim
Ëndërr për Lirinë e Dardanisë, o atdheu im!

Por dashuria forcën,sërish,ma dha për Ty
Plagën time të vjetër ta mjekoja një herë
Amanetin si vathë varun qerpikut për sy
Po qe se do vdisja për fjalën e dhënë
Përsëri do lindesha n'të bukurën pranverë
Zgjuar në Lirinë e Atdheut tim, Dardani.

PRANË BREGUT TIM
(Lasgush Poradecit)

Prenë Bregut të Liqenit ngjyrë Blu po rri
N'furkë t'shpirtit e tjerri hollë shtëllungëmendim
Valët më lagin pa kërkuar falje nga unë njeri
Gjunjët ngulur në zall, shenjë kufiri qëndrojnë
Shpirti po m'resh etjen buzëve t'mia t'çara gjithnjë
Syri palodhshëm survejon horizontin n'vegim
Dhe malli më djeg për atë që m'është tretur
Në lënie gjurmësh si një fosile-skelet i mbetur

Hija po lëkundet nga erëndjenja përtej detit n'valëzim
Mundimshëm përçapet t'ma ngrohë shpirtin e trazuar
Kujtimet si gjerdan përqafur për Shëngjergj t'fëmijve
Përshëndetjet pagane t'gjakut dhe t'fisit n'vazhdim
Dhe unë përmendem nga dehja n'valë mallëngjimi
Nga thellësia e detit t'njelmët, m'del Lasgushi n'këndim
I çartur mes dallgëve në ngritje të flamurit shqiponjë
Të një peshkatari t'vjetër që erën ma kish jelek në gji
Tek tund flamurin e barkës n'përmbytje n'stuhi
Nositi i plagosur që kullon gjak, fitimtarë gjithnjë.

PREMTUESVE BOSh

Nuk durohet rrena asesi…
Nuk tolerohet mashtrimi…
Mos gabo me asnjë veprim
Në jetën tënde ta fitosh dënimin
Unë nuk dua të hakmerrem
Por dhe nuk lejoj të shkelem
Nëse nga ti do t'mashtrohem
Nuk derdhi lot, kot më kot
Por, n'veprim do t'rebelohem
Vullnetit për ta dënuar t'keqen
Madje, edhe pa dëshirën time
Pa qare do t'i nënshtrohem
Ty, do të vë në pamundësi
Veprimin tënd do ta asgjësojë
Me krejt forcën e shpirtit tim,
Atij shpirti të lodhur nga loja
E premtuesve bosh e modern,
Si rebel-kryengritës në veprim,
Do t'kundërvehem, do t'luftojë
Pa hamendje e pa dyshimin tim
Deri në eliminimin tënd të plotë
Tamam sikurse eliminohet
Ndonjë shkaktar për krim.

NGROHJE ZEMRASh

E LIDhA ZEMRËN TIME ME TËNDEN
TA FALA NDJEShËM TËRË DAShURINË
KURORA LULESh TË ThURA ME ËNDJE
E DAShURA IME, MA JEP VEÇ SIGURINË

ÇUDITËRISHT TI SHPEJT LARGOHESh
TANI PËR MUA S' MENDON AS NjË ÇIKË
PËRSE ZEMRA IME AQ DËShPËROHESh?
UNË S'TË LARGOJË, TI VETË MË IKË

N'ShIKIM TË QIELlIT QË ShKËLQEN
NDJEKA NjË YLl QË U ShKËPUT
MOS VALLË JE TI, O YLLI IM
QË PO NGUTESh, QË PO REND
SA NË LINDJE, SA N' PERËNDIM

NUK DO TA ShUAJ KURrË VULlNETIN
AS DËShIRËN E DAShURISË QË KAM PËR TY
PO TË DUASh EDhE PUNËT LE T' RËMETIN, DIJE SE
TË DUA DhE DËShIROJ TË JEM PRANË TEJE
TË MË PËRQAFOSH FORT, PA PYET E PA LEJE

ShPIRTI TË KËRON EDhE NË RËNKIME
VETËM TI E NGROH ZEMRËN N'PËRTIM
MË EJA TË LUTEM SËRISh N'PËRQAFIME
NGA RrUGË E DAShURISË NUK KA KThIM.

ShI NGA RETË

Edhe dega e këputur dhunshëm, sërish ngjalloi
Nga shiu i furishëm që e lëshuan retë
Një pipth, pranverçe, në degën amë lulëzoi
Dhe Lisi krahthyem, frymëshpresën qiti për jetë
Dhimbja, brenda trupit, sërish dhimbjen sfidoi!

Ah, sa e rëndë, e vënë pas shpine, ësht' pengesa?!
Dhe atëherë, ti, ndihesh krejtësisht i vetmuar
Aq më tepër kur shpinën ta kthen dhe besa
S'të ngel asnjë shteg dhiaresh për të kaluar
Po mos të të ngjallet e jotja shpresa...!

ShKËNDIJA QË NDEZ

Një shkëndijë del nga gryka e zemrës
përhudhet n’gurgullimat e saj të arta
ndez qiririn e kujtimeve t’vjetra
nga drita shkëlqen rrugëtimi pa fund
flakadani rend n’udhëtime t’zjarrta
në drejtim t’yllit famëmadh ndokund

Kalorësit e mendimeve të ndryme
i shpalos kujtesa në Ag, një nga një
flaka e purpurt lakadredhet, dhe
djeg kandilen e vet n’salvime,
e vërteta lakuriq rri brenda Unit
kur kujtesa thurr kurora lavdie
derisa koha shëron plagët e murme
nga kafshime të zeza gjarpinjsh
që të helmojnë aty te guri i shtëpisë
sa herë që mendimi yt, bukur i fshinë
përkundjet e trishta të pakohësisë.

ShTRËNGATË GjAKU

Edhe një herë pra: lakmia, smira,.....
Xhelozia, mlefi e ku ta di se çka jo, madje?
Mundimi! Pendimi! Apo dhe Guximi...?
Ta turbulluan mendjen, të frustruar të lanë
Edhe një herë u fute me padurim, nazeplote
Detit të trazuar, asaj nate dimri pa Hanë...
Nuk e dije se ku po të shkon barka e jote
Vallë ku do t'përfundojë, a thua në cilën anë?
A bregut me shkëbinj të thepisur, pendimi ...
Apo fundit të detit thellë, me thembër të zanë?!

*

Edhe nji herë, ti qe viktimë dëshirës sate
Djegia e kredos është përnjëmend mëkatë
A mos vallë qe ambicja e jote, gjithnji, në gufim?!
Dhe ndjenjat sa herë i pate n'shpërgajë, uratë
E frerët e tyre t'këputur, ti, kot i mbaje n'dorë
S'e hoqe dot nga vetja at të gjakut shtrëngatë
E as mërinë e atij shpirtit tënd rebel në trazim...!

*

Dhe koka jote as e thinjur s'do t'provoj' kunorë...!
Pra, thadrimi i jot do të vinte përherë në vazhdim....
Ajo kokë që truni i vet dhe esull ëmbël e gënjen....
Të kotë e ka në zemër at' të paktë që e shpëren!
Vetëm shpirti i bardhë, e udhëheq zemrën në vlim
N'shkelje pahamenshëm shtrëngata e shpërgaja
Terrin e shpirtit ia zbardh veç mendja n'udhëtim
Gjithnjë drejt të ndritshmit, atij t'Bardhit Agim...!

SI NJË FLUTUR.....!
(mikes që i dërgon
lulet me fluturën)

Si një flutur për ne do rend
Mikja e jonë me zemër t'bardhë
Gëzim e hare do të na sjellë
Shpirti i saj melem për plagë...!

Rend moj mike, e dashura mike
Lule m'lue e nëpër trëndafile
Të gjithave moj fisnike merru erë
Ca nga meraku le të digjen kandile
Tjerat le të presën edhe një pranverë!

Lulet e tua që i dërgove sot
Për shoqërinë dhe miqësinë
Ngjyrat e tyre e tregojnë për mot
Të zemrës tënde mirësinë....!

Ajo zemër që rri aty përskaj luleve
Dhe me kureshtje idilën e vështron
Pyet, kjo flutur sa ëmbël po dashuron?
Herë e puth njërin, herë tjetrin e përqafon!

shkruar aty te
Kopshti i Trëndafilave

SNOBIZMIN E VRAS PAMËShIRShËM

Snobistët dhe mund
të ma përlyejnë
vetëmse shikimin, por,
nuk mund të ma ndalin
e as t'ma vrasin mendimin,
ai, nga snobizmi, nuk vritet
atëherë edhe më shumë
rritet dhe ndritet.
Kur hesht dhe rri në kujtiime
më akuzoni me paragjykim
më prekni ku s'duhet,
në jetën time të shenjtë,
pastaj un' hutohem,
rebelohem se zgjohem
e marr rrugën e malit
dhe shaminë bojë alle
lidhur tri here ballit,
sëpatën e gjyshit
vjerun në krah,
si druvar i vjetër,
të mprehur fort
te farkatari Hefest
dhe çelnikosur në
zjarrin e Prtometheut,
e larë e shpërlarë
me ujin e Pusit të Artë,
që buron n'Olimp.
Edhe lisat që ma zënë
rrugën, kur i futem
Përbrenda Malit të Shpeshtë
unë i pres, pa ndjesë
njëherësh dhe pesë ….
në tokë të zezë…

cung i qes…!
Mendimet më kullosin
Lugjeve të Verdha, n’vazhdim.
Snobizmi i shpirtkazmave
sa vie e rritet; përsëritet
ndrydhur e shtrydhur,
si pula pa krye përpëlitet.
Nuk e lënë pa e ngjyer
sado pak dhe
pa e thënë me zë
të vjerun si dështakë
se, kinse thika e tyre
është më e mprehur ???
Harojnë të ligët, se thika,
vetëmse të shpon apo
të therë pas shpinës,
dhe kurrën e kurrës
nuk i bie Lëndinës,
e kurse sëpata,
të bie në lule të ballit,
pa pyet e kërkuar
dëshirat e mallit.
Prapë, snobistët nuk prajnë
por, vetëm shajnë e shajnë..?!
e më thonë se s’qenkam pelegrin,
unë vetëm qesh e qesh
me snobizmin e tyre
sepse, nuk kam kohë
për të humbur…
sa e sa mot për kot,
rrugës sime të gjatë
për Baba Tomor,
pesë here në vit
bëj homazh, se falem
në tempullin e Dodonës,

e Zojsit i kushtoj theror.
Çdo Sh’ Gjergj me lule
Dhe Sh’ Mitër me bore.
Më mirë po rri
e pi venë të kuqe
si gjaku, zier nga oxhaku…
dhe shumë të vjetër
si asnjë tjetër….
Mbush kupën
e Gralit të Shenjtë
si për Darken e Mbrame
dhe vena s’ka të sosur
Shekuj e shekuj rend
sa arrin deri te i madhi
Omer Khajami.
Ah, Rubairat…?
seç ma turbullojnë kokën,
por m’i kthjellojnë sytë e mi
të cilët atëherë e shohin
shpirtin e Krishtit, tek po
vuan për lolot e mjerë…?!
sa here që unë e vë, në buzë,
në buzët e etura për njerëzillëk,
dhe me pak fodullëk, atë
Kupën e Argjendtë,
të mbushur përplot me
Këndime Poetike, mua,
më dilnin snobistët lolo
para syve të mi, sy të cilët
akoma i kam të kthjellët,
si vesë mëngjesi, edhe
ngjyrën Detit të Qetë , që
dashurohet në Qiellin Lot,
ia pata marrë për ata sy
të kaltër, të kaltër - Blu…!

SONTE.....!

Sonte kalla zemrën
me ashk të paparë,
mes sfidash e ankthesh
përpiqem asketçe
ta qendisë vargun
e shpirtit të vrarë.

Se s'duron shpirti
ankthesh urata,
nga përbindsha
fytyra-engjujsh
që, mëngjeseve esull
shpërndajnë dhurata

Sonte ndeza vargun
porsi flakë qiriri, se
nuk i them dot un'
t' pathënat e mia
që s'i do shoqëria
por, mi pa syri, e
mi mblodhi zemra,
një prush i ndezur
ç'më djeg përbrenda?

Sonte kapa Hënën
me bebzën e syrit
thash n'dëshprim-shpresë
le t'ia shtojë pak dritën!
edhe flakës së qiririt

Prore, edhe vargjet
le të ndizen vrrullshëm
fjalët që ato i lidhin
prushin e kanë t’mundshëm

Sonte,…… !
me shpresë prita Diellin
pa vënë gjumë në sy !
Agut t’parë iu luta
zjarrin e t’pathënave
të ma merr në gji.

T Y M N A J Ë T R U R I

(Abdylazis Islamit)

Më tymon truri si llulla e gjuetarit të vjetër
Rrugëtimit tim të gjatë për në P e ll a z g o n i
Nga djegia e mendimeve t'thella, nxjerr blozë të zezë
E prapëseprapë s'arrij dot të ngrohem n'timin perimetër
Fati dhe fatthënat, pamëshirshëm, më mbajnë në agoni
Këtij dimri t'ashpër, mbushur përplot me acar e kranezë
Qepallat n'përhitje për qielli m'varen, unë pres n'përgjërim
Edhe shpirti akullin spic, lëshuar ndër strehë ma ka
Eldorado, ky burim i vrullshëm, vërshen në shpirtin tim
Ëndrra e purpurt, n'gurrë mendimesh m'shpërlahet pa nda.
Nëpër sinorin tim, mundimshëm, "Korrieri Artan Arta" po shkel
Urhëtimi im për në Pellazgoni, më i rëndë se ç'e prita më del?!

U STREHOVA NË ShIUN E LOTVE

U strehova në shiun e lotve të tu
n’t’panjohurën gdhihem me shpresë
Fatin e gjeta si pasuri e fshehur
Shpirti duroi sa s’duron deti ujin
Dhe ndjenjat u enden si vallsi i lules
Herë m’përqafje mua e herë t’hujin[3].

Edhe pse ti fshihesh pas shprehjeve tua
Udhëtimin e bën me paramendim
Cakun e sinon me anijen e t’keqes, lundron
Ti, peshkon n’detin e mlefeve guximshëm
Dhe zhytesh thellë e më thellë me hijet
A kthehesh si peshkatar i pafat...
Bashkë me ta edhe ti hije bëhesh.

[3]të huajin

UJËVARË DAShURIE

Ndjenjat përplot ritëm e mall dashurie
varg e varg rrjedhin si një ujëvarë
ashtu siç vjen edhe dashuria yte
e dalë nga brendia e shpirtit të vrarë

malli lufton dhe brenga e pret
në rrugëtimën e jetës i bashkohet
zemra për zemër fortë do troket
kur dashuria dashurisë i flijohet

përse kaq vuajtje këtij soji t'njerëzimit?
i përjeton shpirti në çaste harmonie
përse iu caktua nga dhënsi i blatimit
veç atij që zemrën e ka ujëvarë dashurie

vetëm ai që ka dashuri të vërtet'
e lind edhe diellin me dashuri të ti'
dhe vdekja e tij ka kuptimin e vet
sërish lindet jeta në një agim të ri

pra, kush ka zemër le të lavdërohet
që për të tjerët madje e dhuron
atij që i duhet në jetë t'i ndihmohet
ai njeri dhe pas vdekjes i gjallë jeton!

VALS I TINGUJVE TË ShPIRTIT

Jeta të vin si dhuratë hyjnore
Ti nuk e pret, as nuk e di
Por shpirti yt i shënon prore
Tingujt e një valsi të ri
N'vallëzim me zemrën
Luan n'ritmin e jetës së re.

Pastaj jeta do hap dhe dritare,
Nga ku tingujt ëmbël do i shijosh
Tek kërcejnë hareshëm n'fluturim
Edhe fluturat luleve do i shikosh
N'kënaqësi të shpirtit, plot gëzim
Valsin e zemrës tënde do ta dëgjosh.

E pra jeta, kjo dhuratë hyjnore
Det i hapur, pa majë, pa fund
Notimi me mend dhe me kuptim
Lum për atë që e kupton prore
Bëhet dirigjent i vetes, me mund
Tingujt e shpirtit i mba n'akordim.

VERTIKALJA

Përherë rrezja ngihet
Nga poshtë lart
Shigjetën mbi supe
Si kokë e mbart
Nuk e pyet kurrizin
Se don apo s'desha
Sepse peshorja e saj
Kurrë s'pyet për pesha

S'lejon rrotullime
Që e vënë për tokë
As dhe horizontalet
Nuk i do për shokë

Lëre më butakët
Dhe pakurrizorët
Prozhmuesit, idhnakët
Larot dhe makutët
Së bashku me hajdutët.
I flak në harresë
Sa i dalin pengesë
S'i përfill për jetë
Nga boshti vetë
Vertikalja s'hesht
Gjithnjë defilon
Rreth boshtit të vet
Ajo rrotullon
Si rrufe Zeusi
Qiellin synon.

VESË TRËNDAFILI

Më duket sikur flaka mu ndez
thellësisht me shikimet e tua
a puthjet, a fjalët magjike
të lutem, mos mi jep mua!
se trupin ma bëjnë prush
mike moj, sa fort të dua

***

ti dukesh sikur vesa n't' bardhin mëngjes
që rri skaj fletës së trëndafilit
n'përqafje t'fortë me rrezen e diellit
ç'më dehin këto nazet e bilbilit?!

***

fladin e verës që ma jep ti,
atë dehje të ëmbël shpirti
nuk ma jep kurkush
madje as më e ëmbla venë
e cilit do qoftë rrush
mike moj, e shtrenjta mike
vitet ikën, a ndjenjat mbetën besnike

***

buzëqeshja jote e brishtë
n'burimin e artë le të lahet
Në shpirtin tënd të pastër
zemra ime peng le të mbahet,
peng i po atij ari të vjetër, se
kujtimet e mia, e vrasin këtë kohë
për një tjetër.

YLlIT AFËRDITA I FALEM

Koha rrjedh e s'ndalet fare
Krua i pashtershëm jeta n'vijim
Kalojnë edhe vitet, e s'kthehen më
Lodhja po duket ashiqare, plakesh
Edhe fuqia fizike po t'mungon
Porse morali forcohet edhe më
Kurse bindja rrënjët më thellë i çon
E vërteta më bindshëm rrugën e trason
Eci e eci dhe nuk ndalem sepse kallem
Yllit Afërdita çdo mëngjes i falem
Mendoj dhe kujtoj detyrën që kam
Udhëtimi im do të arrijë në cak
Përkundër sfidave që dalin pa pra
Se rruga në jetë, që shkilet vetë
Ajo, sot e tash, kthim prapa s'ka

***

Duhet t'ia vëshë të vërtetin prak[4]
Nëse dëshiron që peligrinazhi yt jetësor
Të bëhet hipodrom për këmbësorë
Për ata që dashurohen në flakë
Dhe Unin e kanë të fortë epokave
E gjurmët e lëna në rrugëtim shekujsh
Dukshëm do të bien në sy më vonë
Udhëtimi, shpeshherë nuk ngjason
Por edhe mund të imponohet
Cakun e vet e arrinë vetëm ai që,
Sa herë udhën me "kalldrëm" vetë e shtron
Dhe me mish e me shpirt mundohet
Në vrapimin që i thuan maraton.
Por, edhe një gjë mirë duhet ta dishë

[4] prag

Kurrnjëherë mos nxito, shtruar merre
Fillimin tënd herët ta gdhishë
Udhën mbaje në sy, fortë shkele
Me gjithë shputë, gishta e themër[5]
Mos hezito, nëpër kohë qëndro!
Mëngjesin me Yllin e Afërditës gdhije
Qëllimin tënd sot, nesër, a pasnesër....
Alternativë nuk ke, patjetër arrije...!!!

[5] thembër

BUÇIMË ShEKUJSh

Seç e kam një shkul ndër brinj’
Veç mi bie përbrenda sinorit
Pastaj ngrihet si lavë vullkani
Përplot me zjarr, meteor qiellit
I përflakur më del krahërorit.

Unë buças ndër male e shkrepa
E nxjerr zërin me tingëllimë
Dhe jehona ndër shekuj ikë
Kthehet prapë një shkul i ri
E pas shpine më ngulet thikë.

Shekujt rrjedhin varg dhe vijnë
Ngjitun, varun për qepallash
Unë buçimën më nuk e ndi
Rri i dehur permes ëndrrallash
Por jam ashti që prapë mbin.

ETJE ShPIRTI
(Murat Isakut)

Shpirti të trazohet e t'mbushet me valë
kujtesa, si anije, detit të mendjes t'lundron
Ti, peshkatari i mendimit të artë
dashuria për njerëzimin sot e këtu
nga zemra yte gurrëbardhë të buron.

Fjala jote e kulluar, si qelibar
n'vargëzim e qendisur me mjeshtri
gur i çmuar, rri n'gjerdanin poezi
vargu yt melhem shërues për Plagët
e sfidon dhimbjen me shumë dashuri.

Etjen shpirtit të përflakur
ia shuan veçse vargu i tij
ah, ky "Zani i Malit"?!
porsi uji i Kroit Madh,
n'bjeshkët e larta, atje n'Malësi
kur e fladit trupin që ka zjarrmi.

Nga vullkani që derdhet n'breg
gjaku t'ndizet brenda n'dell
ta nxjerr lavën me shkëndijë
e djeg veten e bën prush, dhe
zemra jote, prapë, ta mbushë.

Sërish, "Delli e di rrugën e vet"
nga buçima e këngës sa s'pëlcet
rreh çekani mbi kudhrën e vet
dhe nga etja rritet forca e tij
kush vdes për fjalën e dhënë është poet
veç ai majat e rrëpirëta mund t'i arrij'.

KLIThMA RESh

Këlthit, këlthit e mos pusho!
Ti, shqipja e maleve, veç fluturo!
Atje lart në qiell, përmbi retë
Sogjimin tënd n’shigjetim lësho
Vendin tim ti fortë ma mbro!

Çaje mjegullën e shpërndaj retë!
Ato rre të zeza që duan me m’rra
Veç klithma jote kushtrim malesh
Rretë e zeza do t’mundë me i ça
Dielli im, prapë, me m‘përla!

XhAKU N' VLIM
(shkrujtun gegnisht)

Xhaki xhi ngrihet n'vlim
Kur vala trupit mrapsht i bie
Ësht' xhaki i zogit t'Arbnit
xhi s'asht' si lot gjelmie
Por xhak i derdhun
Për tok' Shipnie!

GJAKU NË VLIM
(shkruar letrarçe)

Gjaku që ngrihet në vlim
Kur vala trupit befas i bie
Është gjaku i zogut të Arbrit
Që nuk është si lot djalërie
Por gjak i derdhur
Për tokë Shqiptarie!

MEN'IMET RrEShT
(shkrujtun gegnisht)

Koha po e m'barson trunin e stërlodhun
Dhe e ngarkon me barr' qi nuk e mba
Intelekti po vihet përpara nji sprove
Sot e gjithë ditën, askush ket' nuk e ha
Dhe mendimet m'vijnë varg e rresht
Gjithçka qi ndodh sot, un' nesër e ndi?
Men'ja ma thot, kot ti zhurmon e ban za
Porse zemra vlon, asesi nuk e hesht
Se "e gjeg jarganin edhe për nji plesht"
***
Sa nuk durohet ma kjo hipokrizia!?
Qi, me të madhe sot e gjith' ditën,
Po e mbllaçit si e bab'zitun njer'zia
Ndërkaq "Plakat krehen e n'qejfe kan rra"
Brigjet e mia po m'digjen nga baruti
Dhe flaka e tij gjithçka po e përbin?
Nuk e fik dallga, nuk e shuan as moti
Se lotët e nxeht' nuk i mbajn ma syt
Ju lutem ma ngrini, edhe nji her,nga vorri,
Bashk' me topuzin e vet, Gjergj Elez Alin'!
***
Dhe mullini i mendjes, men'ime t'randa po bluen
Jo rrall'herë n'blujtje e sipër i then dhamzorët
Porse shpirti i vujtun sikurse nji katalizues
E rikthen kujtesën e vet, nga kohët ma para
Para syve m'dalin t'vërtetat për mizorët
Dhe mizoritë e tyne, shtruem n'sofër, un nuk i ha

Un jam zarrmi vet’, qi m’vodhi Prometheu
Dhe nuk lejoj tjetërkush me m’shkrumu,
a me m’gjeg’
Për aç, veç sa për me mi shtu dëshmorët
Andaj ju thom:-çdo zarrm n’votër t’vet
le t’rrij, le t’hik!
Mos ma shnd’rroni lotin tim n’rrenim’
At’ zarrmin tuj t’va shuj, për mot t’va fik’?!

NË TETOVËN E KUQE

Aty, në rrënzën e Sharrit Plak,
pikërisht në Tetovën e kuqe,
e cila lind luanë dhe rrit lulkuqe,
burrërisë, fjala e dhënë i vë kapak
trimërisë, besa e burrit i rri bajrak

Aty pranë Hisari n'mendime ka ra
t'bëmat e moçme si gjerdan i mba
Artati kujtimin ia shpërlanë pa pra
Kalaja Ilire llafos me historinë
Fisi i Penestëve nder për njerëzinë
Emblema e fisit si rrudhat në ballë
Qe pesëmijë vjet e ushqen gjeni
Emrin për shpirti gdhendur ma ka
Të trungut Pellazg të gjithë jemi.

UNË KU JAM

Bota si rrota, gjithnjë katrahurë
Lëviz e zhvillohet pa u ndalur kurrë
Jeta dhe kombet në të gjallërojnë
As tokëdridhjet nga brenda që arrijnë
As luftëshkatërrimet jashtazi që i vijnë
Këtë të bekuar zhvillim nuk e sfidojnë
Madje shekujt rrjedhin, largohen vrik
Koha s'kapet as nuk ndalet t'pushojë
Njeriut i duhet pas saj të vrapojë.

Unë ku jam dhe çfarë bëj tani ?
Si tjerët,të njëjtin ajër e thithi gjithandej
A s'është vallë koha,me kombet të matem ?
Në garën e madhe, n'krah të zhvillimit
Edhe vrapin tim, unë andej ta kthej
Veç kështu do të mundë t'i rri vrapimit
Edhe zhvillimi, përfundimisht, të më njohë
N'dije dhe pasuri, t'mos mbetem pas në kohë.

VENDLINDJES BORXh I KAM
(G A J R E S)

Kudo që të ndodhem kudo që të jem
mendja më shkon e zemra ma don
Vendlindja ime mendimin ma mba peng
edhe për gurët e katundit mallin ma çon

Viniki përballë shkollës së vjetër
në krah të përroit, xhaminë shikon
dhe kujtimi për mbrëmjet verore
ku burrat e fiseve deri natën vonë
kuvendonin aty ku krroi e përroi
pandalshëm në rrjedhje gurgullojnë
kujtimet e mia të fëmijërisë
mi zgjojnë përherë, mi turbullojnë
bashkë me ato të krenarisë
për gajranët, që lindën, po lindin
e do lindin më vonë.
* **
Kujtimi sa vie e po më ndritet
respekti për ta, gjithmonë më rritet
për djemt e Gajres, te kshtija[6] n'Vildexhak
aty edhe armikut i bëmë pritë
na ranë të pabesët neve pas shpinës
por djemt s'patën frikë, ata derdhën gjak
istikamet mbushur me fishekë t'martinës
n'pranverën e 2001-shit, Gajrja u bë bajrak.
***
Tanket i ngujuan te Kshtija e Gjatë
vashat edhe gratë si n'gryk' t'Kaçanikut
bashkë me burrnin' e Gajres, ishin tek fronti
bukën e gatuanin n'betejë me erëza baroti

[6] gështenja

pët s'u bënte syri, n'qerpikë u ngriu loti
fronti i luftës shtrihej gjerë e gjatë
murtaja fishkëllente mbi kokat si shpatë
trimat gajranë s'e lëshonin istikamin
sikurse atëherë n'të Kara Eminit
nuk e kishin dert urdhrin e kajmekamit
lidhur ishin fortë për fjalën e betimit
fjala e dhënë qysh në koh' të tmerrit
 të nacionaldemokratit, Shaip Kamberit
***
Gajranët ishin e do jenë përherë
Bilbilat e dijes dhe punës me vlerë
që dimrin e egër e bëjnë pranverë
tradita rrjedh si uji në krrua
ideali i lartë në burrë e në grua
çeta atdhetarësh edhe intelektualësh
kolona profilesh në të katër anët
mjekë, inxhinierë, punëtorë e profesorë
arsimimit t'popullit vet, i vunë kurorë.
***
Gajrja sinonim në Malësinë e Sharrit
kohezion shpirtëror, Besa e Shqiptarit
edhe një herë hijenat turrshëm vërshuan
në luanin e plagosur ata u lëshuan
hesapet i bënë pa e pyet hanxhinë
armatimin e rëndë në kala e shtrinë
ah!- kalaja e vjetër përmbi Tetovën plakë
nga grykat e topave veç nxirrte flakë
djegia me vdekjen, vinte parabollë
qëllonte mbi njerëz në një vijë t'hollë
te armiku gufonte mllefi me mërinë
bombardimi drejt katundit bënte kërdinë
ata që rranë heroj edhe që u vranë
jetën Gajres trime ia falën n'pranverë
ata, yje drite do t'jenë përherë

borxhin ndaj atdheut me gjak e lanë
dhe amanet të tjerve u mbetet për jetë
borxhin ndaj vendlindjes ta lajnë vetë
qofshin në katund apo në qytet
afër shtëpisë tyre,a derdhur botës mbarë
vetëm përkushtimi me punë të vërtetë
borxhin ndaj vendlindjes, ka për ta larë.

Gusht, 2001
Vildexhak-Gajre

KUR BURrAT LIDhEN ME BESA-BESË
(Lidhjes së Prizrenit)

Si filli pashkëputshëm n'endje pa mbarim
Gjeni vetëbartet n'udhëtimin jetësor
Pandalshëm përvijohet labiririnthit
Dashuria me Fjalën e lidhur kurorë
Diademë i rri mendjes dhe shpirtit

Besa e jonë është ai indi në shpirt
Që lidhet pashkëputshëm me të
Dhe ajo lindi nga vetë Perënditë
Fryma hyjnore në te shndrit
Se është e shejntë si vetë Hyjnitë.

Në Malin Olimp ç'u mblodhën një ditë
Besën e lidhën që ta mbajnë breznitë
Fjalimin e mbajti të rrept si rrufetë
Mbreti mbi mbretër dhe mbi perënditë
Me skeptrin e artë në fronin përmbi retë
Amanetin për njerëzimin e la Zoti vetë.

Amaneti përcillej nëpër gjenerata
Ndër njerëz përhapej tamam sikur fe
Shumë popujve në glob iu dha urata
Rrënjët i lëshoi vetëmse tek ne
Brez pas brezi, në gjysh e në gjyshe
Me t'ndritur nipa e të hijshme mbesa
E Madhja, e Shenjta, e Jona, BESA !

Dhe burri hierëndë, me gjak shqiptari
Dikur herët, qysh nga mugëtirat e kohës,
Sikurse ia kishte përcjellur atij i pari
Ashtu ua përcolli edhe ai brezave trashëgues

Këtë diademë që në zanafillë të Hyjnive
Mbajtur përmbi krye nga yjet vezullues
Që nga Pellazgu, ai At i lashtë e i urtë
E deri më sot e këtu, tek babë Shqiptari
Gjeni dhe gjaku n'vetvete mbarështrues.

Mbreti Taulant, me dashuri, atë e zbatonte
Tek ilirë, dardanë, pajonë dhe maqedonë
Që kur në Lidhjen Molose, vetë, i ftonte
Jehona ngrihej dhe gjithandej përhapej
Udhëtonte mes furtunash dhe lemerishë
Një e kish në zemër, po edhe n'vetëdije
Binte e çohej veçse ndër ëndrra lirishë.

Fjala me Besë nuk reshte nuk ndalte
Gjenit i kërkonte ushqim në histori
Sërish gjakun e ndizte, zemrën e kallte
Me Besa-Besë të lidhun deri në Liri

Dhe burri hierëndë, me gjak shqiptari
Pirro i Epirit që nuk përkulej
Në Lidhjen Epirote, në një sofër,
Me vllezër të të njëjtit gjak ulej

Lidhjet vazhdonin nëpër mesjetë
Të lidhura me besën, mes veti, me jetë
Dhe Diadema qiellit ngrihej e shndriste
Sikur Dielli kur i jep dritë Hënës
Në një zemër dhe në një tru niste
Ishte vetë shpirti që donte e fliste
Lidhja e Lezhës lidhej për gjuhë e gjak;
Gjergji i Kastriotëve në të, ylli n'bajrak.
Vullnetin më të madh se mosha e kishte
Dhe amanetin më të fortë se vetë jeta
Vetëm kështu Shqiptaria mund të ishte

Dhe frymë të merrte padërpre sadopak
Gjersa i lindnën trimat e Rilindjes
Që Shqiptarinë e kishin Fe e Atdhe!
Mendja e tyre e kulluar si karat i arit
Shpirti i pastër kaluar edhe qelibarit
Dhe zemra gjakun ua kishte në vlim
Nat e dit punonin e thonin me dhimbje
Do ta bëjmë Shqiptarinë, këtë vendin tim!

Dhe burrat hierëndë, me gjak shqiptari
Ata djem nënash shqiptare, që ishin shumë
Atdhedashuria nga zemra u rridhte lumë
Kur zëri i Atdheut buçiste n'kushtrim
U mblodhën u turrën n'Prizrenin e Lashtë
Fjalën me Besa-Besë burrat e lidhën
Lidhja e Prizrenit diademë xhevahirësh
Atdheu dhe Zoti kështu patën dashtë
Shqiptaria u shtri në tokat e t'parit
Nga Guri Shpuem e deri te Molla Kuqe
Shqiptarët i kënduan, fuqishëm, Lirisë!
Shtylla kryesore ku mbahej e lidhej paria
Nga bijtë më të denjë që pati Mëmëdheu
Qartë shkruhej dhe i thuhej botës pa hire
Anekënd ku dhe vetë zëri timbrin e kishte
Një Atdhe, një Flamur, një Gjuhë ka Liria
Se, "Feja e Shqiptarve është Shqiptaria!"

Gj A R P Ë R O R Ç E

Gjarpërorçe u bie labirintheve të kohës
nga ferrëjeta më zhvishen lëkurat
si relikte muzesh po enden botës
të rënda, jeta ime, mi pret faturat
akoma më e rëndë lëvizja e rrotës.

Më bren meraku i kujtimeve të rënda
në përplasje tek bregu i mallit tim
për ngjitjet asketçe majave në kep
dhe unë i mba të qepura nën lëkur'
dallgëtrazimet, si t'ishin i vetmi kujtim
për ato që sot përkunden në djep,
se për ardhmërinë tonë foleshte dikur.

Fjala sot peshën si dikur nuk e ka
i shkon firë te dara më shumë se bara
s'e çan kush kokën se dhëmballa ka rra
përtypjen e bëjnë sot dhëmbët përpara
për çdp ditë t'lume, n'tryezë më servojnë
dhe më pjekin e më ziejnë; "piç e dixh"
porse nuk janë të kënaqur, ulurojnë
thonë se, nuk qenkam aspak me shije,
as bile nuk qenkam për tu ngënë hiç?!

Do isha më se i lumtur,njeri i kësaj bote
nëqoftëse do mundesha tu bëhem ushqim
të paktën vetëm për një racion ditor
dhe të kënaqeshin një herë në mbllaçim
të gjithë ata që, një kohë të gjatë gumëzhijnë,
veç më ripërtypin, a nuk mund t'më kapërdijnë!

MENDIMET E LIRA

Fjala nuk lidhet me asçfarë zinxhirë
Kuptimi i vërtetë i saj at' e ngre lart n'qiell
Vargu i lirë edhe mund të ngujohet
Edhe ecja e lirë madje bëhet zap ?!
Por shpirti i trazuar nuk mund të pushtohet
Sikurse që nuk zehet me shoshë i zjarrti diell

Thuan se "femra e fut djallin në shishe"
Edhe Ty mund të të fusin në humnerë
Madje edhe jetën të ta bëjnë skëterrë
Të të thashethuan, të të përgojojnë ?!
Vetëm se karakteri i fortë, jo, ai s'nënshtrohet
Prandaj shpirti i trazuar vetëm atij i gëzohet

Edhe pushtuesin mund ta mbashë në shpinë
Vuajtjet sikurse Atlasi t'ia provosh ferrëjetës
Ta flijosh dhe vetë jetën, atë dhuratë sublime
Por ama frerë e ndërgojsë mos i vën vetvetes!
Bëhu ti aktori, roli i të cilit e shkruan historinë!
Se vdes e prapë ngjallet për të lirat mendime.

ASGJË S'ËShTË SI DIKUR

Kurrgjë nuk është më si dikur
As dita, as nata më nuk pajtojnë
Zhvillimi ngritet e rritet gjithnjë
Kosmosit i ngjitet duke thënë një
Pa shkallë, pa litarë, pa flatra të Ikarit
Sepse, projektuesit si Dedali janë pensionuar
Bile dhunshëm janë dërguar të pushojnë
Me urdhër t'mos kenë të drejtë të mendojnë
Madje detyrimisht duhet të flejnë
Sepse, si të këtillë, më shumë do të vlejnë
***
Sonte ,çuditërisht, gjumi nuk më merr
Më ngacmohet çmendërisht "nervus optikus"
Nga dëftime të reja, moderne e post-moderne
Më krijohen imazhe të ndryshme
Për jetën: dikur, dje, sot e gjithë ditën,
E pastaj e pyes veten time,
Po vallë si do të jetë e ardhmja?
Ado të jetë e mëndafshtë,
E purpurt apo e kristaltë???

VATRA IME

Vatra ime gjithnjë rri e ndezur në mua
Ajo më jep ngrotësi shpirti dhe trupi
Aty ku i ka rrënjët identiteti im
Aty rri peng mendimi nga truri e zemra ime
Që i kam t'përflakur , t'përgjakur, përherë n'salvim
Herë-herë i prerë shkurt për tu shartuar
Por ndër Mote të Mëdha qitje piptha nga rrënja
Prapë, tufa grifash qiellzinj, ta kthetronin trupin
Madje të lakonin nëpër rasa e deklinacione
Perandorë e Perandori, pushtues qiellzinj
Por ty ishe dhe mbete për mot
Me emra t'vjetër e t'ri deri më sot
Dhe vatrën e mba të ndezur në mija vjet
Me emrin tënd unik, t'gdhendur n'shpirt,
Përgjatë historisë sate përplot emocione
Kohësh të lashta e të reja, sot e mot!
bamash e gjamash pa lot.

VETËKOMUNIKIM

Disa përmallime përfundojnë me vdekjen
Gjithashtu disa miqësi rifillojnë me vdekjen

Jeta dhe vdekja kanë një bosht rrotullimi
Dallohen vetëm n’ meditim, jo në gjumë

Mendimet, kujtimet bashkë me përjetimet
Rrjedhin e s’ndalen verë-dimër si lumë.

DRITA E YLlIT

Drita e Yllit hapësirën e çanë
Rrugëtimit Shqip edhe muret përmbysë
Sojit përçarës që ndërtuar i ka
Errësirën sterrë më dysh ia grisë!

Dhe drita prapë i kthehet burimit
N'fjetje të ëmbël mëkatet shpërlanë
Sërish lind me Agun e Bardhë, se
Rrugëton shqip nga fillet e njerëzimit!

Dhe YLlI mbetet Yll kudo që të jetë
Dritën dhe shpirtin njësh i mba
Rrezatimi i tij vjen nga brenda, dhe
Djegien sa më të madhe ta ketë
Rrugëtimi i tij më shumë dritë ka !

Pellag, ILIRIDË

Një baladë për kohën që po e jetojmë, shqetësimet të cilat kursesi nuk më lënë të qetë mua dhe disa si unë.

S'KA MË KEQ SE TA PËRBUZËSh VETVETEN

Stinët e vitit, vijnë dhe shkojnë hiç pa u hetuar
Viti nga ditët mbushet, pas tij vjen i riu
Dimër e verë pa u fikur dhe pa u harxhuar
Digjet. Eh, seç po digjet më kot dhe qiriu!
Shkrihet i ngrati, soset dhe përsëri ndizet
Për t'i bërë dritë asaj që thirret gjuhë biblike
Qysh s'e ndër njrëz ylli rra, a Fjala hidhet
E bukura, e ëmbla, ti moj Gjuha Shqipe
Ylli i yt, kurrën e kurrës, nuk do të fiket.

Po ti dreq i mallkuar, ti laneti i zi
Përse po e përbuz sot vetveten
Kujt i shërben me këtʼ demagogji
Ujin e burimit tonë në cilin mulli e çon?
Jo, nuk e fsheh dot më ti të vërtetën
Sepse, e vërteta tani është me ne, ajo jeton
Ajo shihet edhe prapa perdes sate të injorancës
Që, ti akoma nga orienti e mba të lëshuar
Oh, ti i gjori! Mjerrani i kohës moderne
A s'e di se Dielli edhe pse në lindje zgjohet
Prapëseprapë ai ik n'perëndim për të pushuar?!
Dhe nga atje rrezaton fuqishëm që jeta të jetohet
Edhe perden tënde falso, e tejshpon mjaft lehtë.

Jo, kurrë nuk thahet një lumëbardhë i thellë
Që burimin e vet e ka tek mendja e ndritur
Vjen prej asaj mendje të kulluar e të shëndoshë
Të një kombi të fortë, të cilin koha nuk e zhbëri
Edhe pse kalvari i vuajtjeve të tija përgjatë historisë
Ishte i llahtarshëm, përbinte gjithçka që para i dilte
Vuajtjet i vinin nga padrejtësitë e bëra para e pas shpine
Herë herë nga të huajt e ndonjëherë nga dalja prej hullisë

Megjithatë, ai mbeti të dëshmojë për njerëzinë e lashtësinë
Dhe që, brez pas brezi, n'rreze t'arta të rritet e t'kalitet
Gjithmonë zemra dhe shpirtit i tij, dritë ka shndritur
N'rrjedha lumenjsh, pa mbarim, të dijes e të mirësisë
Që i kanë ujitur këto troje të stërgjyshve skeptërmbajtës
E ti sot, kot e ke, bashkë me pronarët e injorancës sate
Sepse, ti dhe ata, nuk ma zini dot Diellin tim me shoshë
Ai diell më ka ngrohur, më ngrohë dhe do të më ngrohë
Përderisa të jetë jeta dhe t'mos jetë sosur e imja moshë
E cila ka lindur me kohën, dhe vazhdon të jetojë në kohë.

Pra ky lumë i thellë, i gjakut të Arbrit, i gjakut blu
Ky lumë djerse, ky lumë lotësh që si flakë djegin
E që rrjedhin me mija vjet bashkë, hiç pa u nda
Duke e lagur gjithçka që i mba e që e prekin
Dhe prapëseprapë bien në tokën e Arbnit
Shndërrohen në lumë njerzish, në lumë fjalësh
Që pastaj të derdhen në lumë letrash, qysh moti
I cili lumë pellgon vrullshëm kah deti i lashtësisë
Palëkundshëm mëton të shkojë drejt përjetësisë.

Pra, nuk ka mundësi të thahet, asesi, ky lumë fjalësh
I gjuhës sonë, kjo fatbardhësi si inxhi, sot e për mot
E cila në vetvete ka përshëndetjen më sublime që ekziston
Ndër gjuhët e gjalla, të cilat sot i flet njerëzia
Me thënien e lashtë, madje hyjnore,"Tu-ngjat-jeta"
Pra, jetën mund të ta zgjatë veçse i Lumi Zot
Dhe në çdo gjuhë tjetër, respekt edhe për ato
Por "Tungjatjetën" e gjuhës shqipe, o shqiptar!
Me asnjë përshëndetje tjetër, ti, kurrë mos e ndërro!
Edhe pse këtë, me të madhe, e dëshirojnë ca trutharë,
Disa çanaklëpirës e do të mjerë që dine veç t'puthin dorë
Me mantel të gjatë, sikurse t'i ketë pjellur vetë nata e zezë
Dhe ca që e veshin trupin me done në vend të pantallonave
E ca të tjerë,të mjerrë, me leshrat lëshuar fytyrës sikurse xhindë
Të parët të ndërlidhur me veprimet e milingonave

A tjerët të hareshëm si të lageshin n'lumin Ind
Dhe, në gjuhë të huaj, fortë, të përshëndesin
Madje duke e vënë dorën bile dhe në zemër
E duke u përkulur paturpësisht si të jenë haxhi
Në fakt, janë më tepër se makutë, dallaveraxhinj
Ndonëse hiqen si t'jenë fetarë të devotshëm
Por në vetvete nuk kanë as më të voglin besim
Edhe jetën e tyre, n'përbuzje, e bëjnë me dyshim
Pra, ata dallkaukët, zhvillimin e popullit të vet
Për jetë të jetëve, kurrë nuk mund ta ndërpresin
Kursesi nuk mund bile as dhe ta pengojnë
Këtë gjuhë hyjnore, të bekuar dhe nga vetë Zoti
Vetëm se si tradhëtarë ata të gjithë do të vdesin
Të përbuzur, si nga i imi, njashtu dhe nga i joti.

Dhe aq më tepër, për do që rrahin gjoks mejdanit
E pëllasin pandalur, institucioneve shkollore e fetare
Me pandërgjegjshmërinë e tyre ma të madhe
S'e na qenkan madje edhe të shkolluar bylmesat
Fatkeqësisht, mendjen e tyre e kanë të turbulluar
Dhe si po veprojnë sot, druhem se mund tu kullohet?
Ngase injoranca e tyre, veç po rritet e po shtohet
Kështu si e kanë nisur ata, do të ngelin të vetmuar
Njësoj si këndesat majë plehut duke kënduar.

Dhe ju, njerzit me idiotizmin e klasit të parë
Që e keni shitur tepër lirë shpirtin tuaj
Edhe ashtu të varfër dhe pa ndershmëri
Tek të tjerët, tek arabët e zi, pranse këtu
Këtu në këtë vend të bekuar por edhe të sharë
I keni arabët tuaj të bardhë bile me qindra mij
Edhe pse u shitët për një strajcë tagji
Mos haroni, ore të ngaratë, se jeni shqiptarë!
Edhe pse zemrat ua kanë shpuar tejpërtej
Mandej radhitur në pe sikurse rruazat në tespihe
Perëndia u dashti dhe u krijoi si shqiptarë
Me kulturën, gjuhën dhe zakonet e të parit

Ti sot, vetëm për atë tagjinë e ëmbël tënde
Identitet, kulturë, doke dhe gjuhë të Nënës Loke
Të kombit tënd të mençur, ti, keq i nëpërkëmbe
Por, mos haro! Ti Shpirtëshitës, zemërbosh
Jezit, plëngprishës, shkatërrues vlerash, ti kodosh
Se ata që tradhëtojnë dhe përbuzin vetveten
Asnjëherë nuk mund ta kenë të lumtur jetën
Madje edhe krijuesi që vetë ata i krijoi
Pikërisht mu këtu në këtë vend
Dhe kështu sikurse edhe ti që më je
As ai, ndryshe nga ky realitet, nuk i do
Po nuk ndryshove,tani dhe vetëm tani
Ti do të mbetesh një njollë e pashlyer
Që, karakterin dhe ndërgjegjen e vet
I ka shkarravitur edhe keq i ka përlyer
Shndërruar në një si fluskë sapuni i ka
Me të cilën nuk mund të lahet llumi
Sepse ajo nuk vlen për hiç gjë! Pa çka?
Dhe nu theftë apo më dysh të çahet
Nga kolona e pestë, pa dashje të ndahet
Me do tjerë, nga soji i yt, e zëvendësojnë
As që ndjejnë dhembje e as që lotojnë
Për do gogla që radhiten në varg-kurorë
Dhe sa herë që tu teket i heqin me dorë
Plugu i tyre lëvron vetëm ndër të huajat ara
Tërhiqet nga qetë e huaj, zënur në zgjedhë
Mbjelljen që e bëjnë ata, të keqen e ka te fara
Prandaj për ata, është vetëm se e një rëndësie
Ta kenë numrin e plotësuar në atë varg
Të zemrave gogël, që hiqen nëpër tespihe.

Më mirë është pra, ta pranosh kryqimin tënd
Për të vetmen arsye, sepse kauzën tënde ti e duash
Gjithmonë ta thuash të vërtetën dhe vetëm të vërtetën
Madje edhe po të të kërkohet ty, kurdoqoftë
Që ta sakrifikosh, për të vërtetën, edhe jetën tënde

Vetëm e vetëm identitetin tënd kombëtar ta ruajsh
Ti, bëre atë bile me mburrje, do të jeshë lavdimadh
Sesa të kënaqesh në mbllaçitje të asaj tagjie, me ëndje
Të asaj tagjie helmuese, që të huajt ta japin
Do mendjelehtë që sytë e tyre i kanë dritëerrët
Dhe që të futën ty rrugëve qorre, pa shteg e pa krye
Ta përhapësh paturpësisht, në mes të ditës, gënjeshtrën
Kështu, gjithçka në jetë për së mbrapshti ti e ke kthye'.

Pra, shqiptar, ti mirë mendo, kujto e vepro!
Se, kurrën kurrës, nuk të prishi punë konfesioni
Ti ke veç një gjuhë, një atdhe, me tri fe shqiptari
Të tria bashkë japin dhe marrin, jo si të huaj
Sepse, një ishte dhe i tillë vazhdon të mbetet kroi
Ku ti, por edhe unë, në gjuhën shqipe etjen e shuaj
Me këmbëngulje amanetin e stërgjyshërve e mbaj
Dem baba dem, ashtu sikurse na e la Ati jonë, i pari
Njashtu po të them ta mbashë në zemër, edhe ti, or daj'!

NË TETOVË FOLE TË KEM

(atje n'Gajre edhe un' shtëpi kisha)

Çdoherë nga mallëngjimi,
kur unë rëmbehem vrullshëm, rrufe
dhe lotët më rrjedhin faqeve rrëke
nga kujtimet relikte të mbetura n'harim
për kohën e shkuar që s'kthehet më
unë kthehem si hije jete në kalim
puth e përkëdhel çdo pëllëmbë dheu
të vaditur me djersë të trupit tim
atij zhegut të verës në përcëllim
anekënd tokë-sinorit të Atit tim

Në Tetovë, un' dua që, fole të kem
un kurbetqari që shkela globin mbarë
dhe kur t'më resh bora mbi flokë,bardhem
të kem pse po kthehem në vendin tem
me vuajtjet kalvar të trupit e shpirtit
ta kem votrën ku do t'i rrëfejë, do t'i them
brenga e mallëngjimi le të mbeten "rekuiem"

Ah, lotët m'rrjedhin si uji i Shkumbinit
që i bie mes e përmes Tetovës së kuqe
e derdhen në pellgun e Bardharit, notojnë
bëhen bashkë me lotët e Motit Madh
ky Mot, do të vij, sërish do shndrij'
krahhapur ëndrrat n'Pellazgji m'burojnë
dhe veç Moti Madh do t'i zhgjëndërrij'[7]

[7] zhgjëndërrojë

Atje në Gajren time unë shtëpi kur kisha
zemra më mbushej përplot me ngazëllim
kur shikoja pusin ku Gjoku dimrit ujë pin[8]
dhe dy portat e mëdha stolisur me frëngji
nga ballkoni i saj, sa herë, Tetovën e sodisja
dhe shikimi më shkonte lindje e veri, e
m'ndalej tek Kalaja që mileniumet përbin
krenare ndër kohë ajo gjithnjë rri!
as tufanet as retë e zeza s'e kanë bri'[9]
si nusja në pajë, në heshtje nusërin
përballë Gajres krenare e bën historin'.

[8] pi
[9] brejtur

NJIQIN VJET Th'RrAS E TROKAS
(g e g n i sh t)

Njiqin vjet Pamvarsi
Njiqin vjet pa Shiptari
Feston Kosova,Ilirida,Çam'ria
Presheva madje dhe Mal'sia
Dit'n e Flamurit Kuq e Zi
Dhe e pret ditën e Liris'
Për pamvarsin' e Shipnis

Un po thrras e po trokas
Anekand globit, botës
Për njiqin vjet hiç pareshtun
Portave t'mdhaja t'parlamenteve
Se s'kan mund për me m'heshtun
M'kan da hise nga fati i rrotës
Për me bredh anemban botës
Njiqin vjet i bie ndjenj's
Çekani i ngjarjeve n'kalendar
Njiqin vjet i thirr ndërgjegjes
Ttroket e pret Bashkimin Komb'tar

Heci detit, heci edhe tokës
Nëpër gjeografin' e tan Evropës
Për Tokën Time baj kërkesa
Sa paradoks dhe sa çudi
Sa e pashpirt asht kjo njerzi?
As me kuvend e as me shkresa
Ndërgjegjja Evropës nuk i trazohet
As ather' kur Toka Ime m'coptohet

Heci dhe i kërkoj yjet nëpër qjell
Rrugtimi jem asht i gjat', i v'shtir
Cilindo qi takoj m'bahet djell
M'ban drit' për Atdheun tem t'lir'
Dhe un prap' festoj ndonse n'dyshe
Mes pushtetesh a n'Trojet e Mia
Festën e mba e gjith Shiptaria...
Edhe pse realiteti m'flet ndryshe.

Po un s'hek dor' e s'kam me u ndal
Nga pelegrinazhi jem n'pranver'
N'Baba Tomor, atje kam me u fal
I përkushtuem edhe me nder
Me vetë bekimin e perenis'
Te Molla e Kuçe Flamurin Kuq e Zi
Bajrak darsmor'sh e kam nxjerrë
Për nusen hypun n'Kal t'Bardh
Qi vjen për 100 vjetët e Pamvarsis'.

Ora 23:40
21.11.2012
Sheshi Flamurit

BISEDË E NXEHTË

E dëgjoi engjëlli një herë
Bisedën bizare pas dere
Ku fjalët i çonte një erë
Si një fllad i këndshëm vere

Politikani i ulur rehat në fron
Llullën e mendimit etshëm e thithte
Atë rëndë e timoste sikur t'ishte balon'
Mes mjegullës veten të lumtur e shihte

Ndërsa poeti i qetë qëndronte
I ulur nga ana e perendimit
Gjykimin e drejtë ta firmoste
Mendimin vargan pas mendimit

Biseda bëhej për "L i r i n ë"
Nga anë të ndryshme pozite
Ajo shumë jetësore për njerëzinë
Fjalët dilnin nga njerëz prej elite

Politikani me grusht rrehte gjoks
Lirinë, thot:-do ta sjellë si më duhet mua
Pa çka se dikush e quaka paradoks
Ajo më siguron mundësinë për të veprua
Tamam si e do puna, njashtu si unë e dua
Hambarët me dënga t'i mbushi
Ashtu si më thot dhe babushi

Poeti fjalët mirë e mirë i bluante
Disa herë e përtypte mendimin
Pastaj dhe në letër i shkruante
E thonte: Lirinë e dua për të tjerët
Ashtu si syri i zemrës ma sheh
Dhe shpirti i vuajtur për vete ma njeh
Ku meritore për gjithçka do të jetë vlera
Pa i dalluar stinët sikurse dimri e vera.

P Ë R M B A J T J A

1. B E S A(për fjalën e dhënë)..... 5
2. BRENDAZBRAZËTIA..... 7
3. DAShURIA QË FLE NË ZEMËR 8
4. DËShIRAT E ANIJES..... 9
5. DhJETË MINUTA NË VIGjILJE TË VITIT TË 10
6. DRITË ShPIRTI..... 12
7. EDhE LISI E NDJEU..... 13
8. FESTA E FLAMURIT 14
9. FJALA RrËZON URA..... 15
10. FJALA MBETI N'GRYK'(poetëve që ndërruan jetë si Gjakush Tana)..... 16
11. FLETË JETE..... 17
12. FRYMË E DAShURISË..... 18
13. GURI I ShKRELËVE(Azem Shkrelit)..... 19
14. KALI BARDhË DhE DELFINI..... 20
15. KThEHEM I DËShPËRUEM..... 21
16. KUR DhËMBALlA DhEMB..... 22
17. KUR S'QËLION NË CAK..... 23
18. 18. LIRO ShPIRTI N....! 24
19. LULJA E KOPSHTIT TIM 25
20. MALl ZEMRE..... 27
21. MANUShAQES SË ZEMËRUAR..... 28
22. MASKAT DO T'BIEN..... 29
23. MENDJEPËRQAFIM..... 30
24. METEORI ARVANIT(Aristidh Kolës)..... 31
25. MUNGESA PËR TY..... 32
26. NDENjAT LUAJNË TANGO..... 33
27. NË GjALlIM..... 34
28. NJË SHPRESË ZEMRE 35
29. N'KRAH T'LULEVE..... 37
30. PAKËZ DRITË PËR NjERËZINË..... 38
31. PAMJE JETE..... 39

32. PËR TY ROZAFË..... 40
33. PËRKËDhELJA E VITEVE..... 41
34. PLAGA IME E VJETËR..... 42
35. PRANË BREGUT TIM(Lasgush Poradecit)..... 43
36. PREMTUESVE BOSh..... 44
37. NGROHJE ZEMRASh..... 45
38. ShI NGA RETË..... 46
39. ShKËNDIJA QË NDEZ 47
40. ShTRËNGATË GjAKU..... 48
41. SI NJË FLUTUR..! (mikes që dërgon lulet me fluturën)..... 49
42. SNOBIZMIN E VRAS PAMËShIRShËM..... 50
43. SONTE.....! 53
44. TYMNAJË TRURI(Abdylazis islamit..... 55
45. U STREHOVA NË ShIUN E LOTVE..... 56
46. UJËVARË DAShURIE..... 57
47. VALS I TINGUJVE TË ShPIRTIT..... 58
48. VERTIKALJA..... 59
49. VESË TRËNDAFILI..... 60
50. YLIIT AFËRDITA I FALEM..... 61
51. BUÇIMË ShEKUJSh..... 63
52. ETJE ShPIRTI(Murat Isakut) 64
53. KLIThMA RESh..... 65
54. XhAKU N' VLIM(shkrujtun gegnisht). 66
55. GJAKU NË VLIM(shkruar letrarçe) 66
56. MEN'IMET RrEShT(shkrujtun gegnisht)..... 67
57. NË TETOVËN E KUQE..... 69
58. UNË KU JAM..... 70
59. VENDLINDJES BORXh I KAM(GAJRES) 71
60. KUR BURrAT LIDhEN ME BESA-BESË(Lidhjes së Prizrenit)..... 74
61. GjARPËRORÇE..... 77
62. MENDIMET E LIRA..... 78
63. ASGjË S'ËShTË SI DIKUR..... 79
64. VATRA IME..... 80

65. VETËKOMUNIKIM 81
66. DRITA E YLLIT..... 82
67. S'KA MË KEQ SE TA PËRBUZËSh VETVETEN.. 83
68. NË TETOVË FOLE TË KEM(agje n'Gajre dhe un'shpi kisha)..... 88
69. NJIQIN VJET Th'RrAS E TROKAS(gegnisht)... 90
70. BISEDË E NXEHTË..... 92
71. P Ë R M B A J T J A..... 93
72. C I P..... 96

KASAM ISMEN ShAQIRVELA

VALS I TINGUJVE TË ShPIRTIT

Përgatitur për shtyp nga
Shtëpia Botuese " **V E L A** "

Boton: JETA-AIR
T e t o v ë
2012

B o t u e s
Kasam ShAQIRVELA

Realizimi kompjuterik:mr.*Blerim Shaqiri*

Kopertinat:mr.*Arta Shaqiri*

Tirazhi 500 kopje
U shtyp në Shtypshkronjën "TringaDesign" – Tetovë, 2015

Botimin e librit e ndihmoi " V E L A group", si dhe :
"DENTAL MEDIKA" – Tetovë; dr. Sherif Shaqiri
"OBALA" – Dubrovnik; Inis Asani
"Ridafarm" – Bogovinë; Besnik Asani

CIP - Katalogimi në publikim
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shn. Kliment Ohridski", Shkup
...

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497.7)-1

SHAQIRVELA, Kasam
Vals i tingujve të shpirtit / Kasam Shaqirvela. - Tetovë : Vela, 2015. - 96 f. ; 21 cm. - (#Biblioteka #Muza)

ISBN 978-608-4516-05-7

COBISS.MK-ID 98138122